

*Xhevahir Cironqu*

# *Livadhi në mal*

*Përralla për fëmijë*

**Livadhi në mal**  
(Përralla për fëmijë)

**Autor:**  
Xhevahir Cirongu

**Hyrja:**  
Kadri Tarelli

**Ilustroi:**  
Fatbardha Lile

**Botimet Jozef – Durrës 2017**

**ISBN**  
978-9928-241-12-2

# Rrëfenja dhe përralla për fëmijë

Fëmijët e vegjël tani do të kenë në dorë një libër të ri dhe do të kënaqen me rrëfenja e përralla të bukura të shkruar me aq dashuri e përkujdesje nga shkrimtari i njohur Xhevahir Cirongu. Pas shumë shkrimeve të publikuara në shtypin e shkruar dhe në faqet e internetit Xhevahiri guxon e provon të futet në livadhin dhe lëndinat e letërsisë për fëmijë duke sjellë e mbjellë edhe disa lule të tjera plot ngjyra dhe erëmirë.

Të shkruash për fëmijët në pamje të parë duket e lehtë po nuk është kështu, përkundrazi shumë e vështirë; kështu kanë thënë më parë ustallarët e kësaj gjinie të letërsisë. Vetëm kur ulesh, provon dhe hedh në letër fjalitë e para, kupton se sa e vështirë është të hysh në botën e fëmijëve, të gjesh fjalët e duhura, që ata t'i përjetojnë ngjarjet, dhe të mbushësh mendjen dhe shpirtin e tyre me ndjesi e guxim, ëndërra e fantazi, mençuri e trimëri, durim e maturi për shokun e mikun, nderim e miqësi. Po kaq e vështirë është të bësh

që të pranojnë e të mësojnë nga gabimet, të dënojnë sjelljet e shëmtuara e teprimet duke ngjallur përbuzje e neveri për të ligun, të keqin dhe armikun, gënjeshtarin e tinëzarin, hajdutin, kusarin dhe tradhëtarin.

Të hysh në botën e fëmijëve kërkon së pari t'i duash ata me shpirt e zemër, në të kundërtën as mos e merr mundimin të mendosh për ta e më pak të shkruash. Së dyti, mbase më e vështira, duhet të bëhesh edhe një herë i vogël me mendësitë, dëshirat, çapkënlleqet dhe fantazinë e moshës. Në këtë libër të vogël edhe Xhevahiri provon të jetë edhe një herë i vogël, ndaj me shumë durim i merr për dore “shokët e vegjël” dhe i shëtiti nëpër vendet, malet e kodrinat, pyjet, pemët e korijet, lumenjtë, përrënjtë e burimet. Ai nuk lodhet duke vrapuar e mbledhur fruta e lule, më pas freskon fytyrën dhe ulet të shuajë etjen duke vënë buzët në pasqyrën e burimit të ftohtë e të kulluar.

Shkrimtari është dhe bëhet i besueshëm sepse lëviz pikërisht aty ku ka kaluar edhe vetë, këput lule dhe gjethe, dëgjon gurgullimën e ujit që rrjedh, fëshfërimën e drurëve e të shkurreve, bashkë me ta edhe këngën e zogjve, takon

kafshë, shpendë, zvarranikë e plot gjallesa që i njeh mirë, “bisedon” me ta duke ia ditur edhe gjuhën.

Në këtë libër të bukur gjejmë edhe njohuri e fjalë të panjohura për fëmijët që jetojnë në qytete, ku lidhjet me natyrën janë më të kufizuara e më të pakta. Shkrimtari me delikatesë na kujton fjalë të harruara edhe nga të rriturit. Po sjell disa vogëlima të bukura sa për kujtesë: eshka, guri i strallit, masati, çibuku, vegla që i përdorin sot vetëm barinjtë që kullosin bagëtinë nëpër bjeshkë e kodrina ose pleqtë që nuk u ndahet shpirti nga bukuritë dhe shija e veprimeve të rinisë. Po kështu me mjaft kulturë biologjike na rrëfen pjesë nga jeta e gjallesave, si gjarpëri nën gur, foletë e pëllumbave të egër nëpër zgavrat e gurëve, jeta e vetmuar e nepërkës së shullërit, helmi i fortë i akrepit bisht’harkuar etj, etj.

I mbetet lexuesit të vogël që të bëjë vlerësimin e këtij libri, megjithse unë jam i bindur se do t’u pëlqejë e s’do ta lëshoni nga dora dhe do ta bisedoni mes shokësh, mbase edhe mësuesin dhe me prindërit.

Po kështu i takon edhe familjarëve, vëllezërve dhe motrave në shtëpi, që të japin vlerësimin dhe gjykimin për dobinë edukative të rrëfenjave, të cilat i bëjnë fëmijët më të mirë, më të ditur, më punëtorë, më të zotë, më të sjellshëm dhe qytetarë të mirë.

**Kadri Tarelli**

**Durrës më 13. 06. 2016.**

## **Mbreti dhe molla e kuqe**

Ishte një ditë e bukur me diell. Mbreti kishte dalë në ballkonin e katit të tretë të vilës e po vështronte disa re të bardha që po dilnin nga kupa e qiellit. Si u mendua pak, vështroi poshtë bahçesë në oborr. Ato re të bardha që i ngjanin çarçafit të jorganit të gjumit i ngacmuan memorien dhe diçka tha me veten:

-Po sikur t'i them bahçevanit që atje tek ai cep i oborrit të mbjellë një mollë! Ç'më duhet ajo shkurre plot gjëmba në oborr! - Kjo e mundonte prej kohësh mbretin dhe në shpirt e griste si ata gjembat e asaj shkurreje pa frute që kishte mbjellë në fund të atij oborri plot gjelbërim me pemë e lule të ndryshme.

- Epo, u tha u bë - vendosi më s'fundi mbreti atë ditë tek vështronte kupën e qiellit, ku

**lodronin retë shtëllungore, të bardha, të cilave rrezet e diellit të pranverës u jepnin edhe më shumë shkëlqim bardhësisje.**

**Bahçevani plehronte dhe i prashiste pemët e lulet nëpër kopësht. Ai u shërbente bimëve si të ishin fëmijët e tij. Ashtu si mbreti edhe e zonja e tij ishin të kënaqur nga shërbimi e puna që bënte bahçevani.**



**–Eja të pimë një kafe - i tha më s’ë fundi mbreti bahçevanit. –Si urdhëron - ia ktheu**



përgjigjen ai por mendja i shkoi për keq sepse s'i kishte ndodhur asnjë herë më parë kjo skenë kaq e pa pritur e befasuese...! Një bahçevan të pinte kafe me një mbret! Çudi!? Por ja edhe ndodh, se fatit nuk i dihet.

Ngjiti shkallët e u ul afër mbretit.

-E di pse të kam thirrur - i tha më së fundi mbreti.

-Jo zotëri - ja kthen përgjigjen bahçevani.

-Kam një mendim, por je ti ai që do e realizosh atë. Je dorë flori për punën që bën - i tha me ëmbëlsi këto fjalë bahçevanit, mbreti. Ai e pa me kureshtje nga koka deri te këmbët bahçevanin dhe ndjeu deri në shpirt shqetësimin që i solli ashtu pa pritur ulja me të për një kafe.

Por... edhe bahçevani po mendohej shumë në atë çast, tek po pinte kafën me mbretin.

Si pinë kafetë, shoqëruar edhe me një limonatë portokalli, ashtu si me një ton urdhërues, mbreti i thotë që në vend të shkurres me gjemba të mbillte një pemë tjetër.

-Kam menduar që atje do mbillet një mollë. Kur të lulëzojë, të marim mollë të kuqe prej saj.

Si dëgjoi këto fjalë që i tha mbreti, bahçevanit ju skuqën faqet sikur të ishin mollët e kuqe që donte mbreti.

-Kjo është punë që bëhet - foli i gëzuar bahçevani.

Pas disa ditësh në vend të shkurres me gjemba u mboll molla. Kaluan disa vite, molla lulëzoi e hyri në prodhim. Kishte patur të drejtë mbreti sepse frutat e kuqe të asaj molle i dhanë bukuri oborrit para vilës. Kush hynte e dilte në sarajet e mbretit, merrte nga një mollë të kuqe. Këtë s'e kishte vënë re mbreti, ngaqë sytë s'i hidhte shpesh nga retë e bardha që dilnin herë pas here nga kupa e qiellit. Meqënsë kishte kohë pa dalë tek ballkoni, një ditë vjeshte, kur kokrrat e mollëve ishin skuqur si flakë zjarri, vështroi drejt asaj peme magjike. Kujtoi se frutat e mollëve ishin të pa prekura në degët e pemës, por kur pa se në degë kishte mbetur

vetëm një kokër dha urdhër rojeve që ajo kokërr e vetme të ruhej e të mos këputej.

-Mirë i thanë rojet mbretit do ta ruajmë....!  
Por edhe atë kokërr të vetme, që kishte mbetur, ia morën mbretit. Thirri rojet dhe u dha urdhër të gjendej vjedhësi i mollës. Mbreti u trishtua shumë nga kjo skenë që s'e kishte menduar kurrë se do i ndodhte atij. Rojet u vunë në kërkim të vjedhësit të mollës. Sipas mbretit hajduti do të ketë qënë i gjatë me trup, ngaqë molla e kuqe ishte në degën më të lartë të pemës. Kërkimet u përfshinë në qytet e në fshatrat rreth qytetit. Para mbretit rojet sollën një burrë të gjatë. Ishte një fshatar me trup të madh dhe i gjatë, që dallohej nga të tjerët në pazarin e fruta-perimeve të qytetit.

“Sipas mbretit, ky duhet jetë hajduti” menduan rojet.

- E sollëm hajdutin - i thanë mbretit ata. Mbreti e vështroi nga koka deri tek këmbët fshatarin e i tha:

- Zgjate krahun deri tek ajo degë e mollës atje lart.

Fshatari zgjati krahun por s'mundi ta kapte degën e mollës ku donte mbreti. Mbreti u inatos dhe urdhëroi rojet që ta linin të lirë fshatarin. Urdhëroi përsëri rojet që të vazhdonin kërkimet për të gjetur hajdutin me trup të gjatë, sepse sipas tij, i tillë duhet të ishte ai që i mori mollën e kuqe.



-Nuk është ky hajduti. – u bërtiti si i marrë mendësh, mbreti rojeve. Aty e kuptoi fshatari përse e çuan tek mbreti. Ai u la i lirë e shkoi në punën e vetë. Kërkimet vazhduan për të

gjetur hajdutin. Por më kot. Mbreti vendosi se ai që do thonte të vërtetën, do të shpërblehej me flori. Lajmi mori dhenë....! Mbreti dilte e vështronte çdo ditë tek ballkoni. Mbas një kohe, një burrë i shkurtër troket në portën e mbretit. Rojet e futën brenda në oborr, ngaqë ai u tha se donte të takonte mbretin.

-Ç'e mirë të solli. - i tha mbreti njeriut të sapo ardhur atë mëngjes.

- Po ja ...si të them ... - dhe iu mor goja kur shqiptoi fjalët "Unë jam hajduti i mollës tuaj o mbret!".

-Me kë tallesh ore shkurtabiq! E di ç'të punoj ty! Ja atje në majë të pemës të var në litar.

- Unë e mora mollën e kuqe të betohem për atë zot!

- Si e more?! T'i je i shkurtër. Mashtrues, mashtrues! - i bërtiti mbreti.

-Të betohem, unë e mora....!

- Më trego atëherë si e more mollën atje lart në degë?!



- Fare thjesht o mbret. Unë me të vërtetë jam i shkurtër, ashtu si thoni edhe ju, por mollën e mora unë....! Rojet ishin në gjumë kur unë hyra në oborr. Si i vogël që jam hipa degë më degë e u ngjita deri atje tek kokrra e mollës. Po kështu zbrita e u largova. Më kot kërkoni hajdutin e “gjatë” kur ju paguani rojet për të ruajtur vilën dhe bahçen tuaj....! Ja kështu ta mora mollën, prandaj erdha të them se pagesa më përket mua e jo rojeve që ti i paguan.

**Mbretit si kishte shkuar ndërmend kjo që i tha ai burrë i shkurtër, por i zgjuar. Si u mendua pak, nuk desh të turpërohej, sepse lajmi kishte marrë dhenë, dhe njeriut trupshkurtër që u paraqet si “hajdut” i dha edhe shpërblimin që kishte premtuar.**

**Epo kështu e pësojnë edhe mbretërit të cilët vënë në plan të parë pasurinë e jo mençurinë - tha burri trupshkurtër e u largua nga kishte ardhur.**

## **Gjarpëri pikalosh, akrepi bisht gjysmë-përdredhur dhe harabeli sqepverdhë**

Atë ditë u befasova aq shumë kur pashë atë gjarpër pikalosh kryeneç, që mburrej për bukurinë e tij ndaj akrepit bisht-kthyer në gjysëm harku. Prandaj më erdhi në mendje një fjalë e urtë e cila thotë: “Kur mburret i ligu ç’mbetet për të thënë i miri i kësaj bote!”. Por megjithatë ka të tillë në këtë botë të madhe e të gjerë. Të mirëve u mbetet të dëgjojnë gjer në fund speciet e këqija, madje edhe t’i respektojnë deri në kufirin që u lejohet, sepse kultura e të diturve shkrep si gur masati mbi eshkën që ndez zjarr, vetëm atëherë kur vjen momenti i duhur.

Gjarpëri pikalosh ishte strukur nën një gur të madh. Aty gjente qetësinë e tij, ngaqë jashtë dielli përvëlues i korrikut të përcëllonte e



digjte si saç. - Këtu jam mirë, -thoshte gjarpëri me vete. Në këtë fresk s'do të kem edhe etje për ujë! Kalonin ditë e netë dhe ai rrinte i vetmuar te ai gur. Ndonjëherë i thoshte vetes se ishte zvarraniku më i bukur i tokës. - E kush helmon më fort se unë kur kafshoj speciet e tjera të gjalla që lëvizin apo fluturojnë mbi tokë!? Si unë s'ka tjetër... Unë edhe mblidhem e shtrihem si më do qejfi, sepse këmbët e mija janë të fshehura brenda trupit tim. Kështu mburrej gjarpëri pikalosh nën hijen e atij shkëmbi.

Kalonin ditët si pa kuptuar e gjarpërit iu mbaruan energjitë. Ai ndjente lodhje, por edhe etje për ujë. Kishte edhe uri sepse s'kishte ngrënë asgjë gjithë ato ditë ngaqë s'kishte gjuajtur në pyll. Por fati e ndihmoi në ditën e vështirë. Një harabel i vogël, i cili ndodhej në folenë e një peme atje më tutje, po bënte akrobacitë e fluturimit. Fluturoi disa herë në qiell të hapur, duke bërë rrugë të shkurtra, ngaqë po fluturonte për herë të parë. Këshillat e nënës i zbatonte së bashku me vëllezërit e motrat e tjerë për t'u bërë pas

kësaj të aftë për fluturime të gjata në qiellin kaltërosh.

Mirëpo ç’ndodhi atë ditë!?

Harabeli sqepverdhë nuk iu kushtoi shumë vëmendje porosive të prindërve. U zgjua herët në mëngjes e fluturoi i vetmuar në qiell të hapur. U largua shumë larg nga foleja që ishte në pemë. Krahët e vegjël të mbuluara me pupla të buta s’po i rezistonin presionit të ajrit, ngaqë ishte ngritur më lart se duhej. Po ndjente lodhje e krahët mezi po i lëvizte.

-Po tani si të veproj tha me vete harabeli sqepverdhë. Nga çasti në çast ai edhe mund të humbise ekulibrin e flurturimit e të rrëzohej në tokë. Ishte në rrëzik për jetën. Koha s’priste më. Vështroi poshtë në drejtim të tokës dhe pika më e afërt për të zbritur nga qielli për të ndaluar në tokë ishte ai gur i madh që gjendej larg pemës ku ishte edhe foleja e zogjve. Kjo ishte e vetmja rrugë shpëtimi për harabelin. Si u mendua pak mori rrugën e fluturimit drejt zbritjes te ai gur. Me vështirësi ia arriti qëllimit: u ul te ai

gur. Ishte i lodhur por ndjente edhe gëzim sepse shpëtoi nga rreziku për jetën. Mori frymë thellë e vështroi folenë atje në pemë. Si u mendua pak tha: “Kjo të gjen kur nuk zbaton këshillat e prindërve!”. Po shplodhej.

## **Harabeli sqepverdhë**

Por një rrezik edhe më i madh e gjeti atje, te ai gur. Ai nuk e dinte se aty ishte i fshehur gjarpëri pikalosh. Sapo u ul harabeli mbi gur, gjarpëri e nuhati dhe po bëhej gati ta kafshonte. “Ja hodha edhe këtë radhe.” tha gjarpëri me vete. “E kush shkon gjer te ai burim në këtë vapë korriku...! Kam fat se kot nuk jam gjarpër unë, - tha këto fjalë i gëzuar ai. Harabeli mblodhi energjitë dhe po bëhej gati të fluturonte drejt folesë. Dëgjoi një oshtimë çjerrëse që vinte nga poshtë gurit.

Kjo e frikësoi shumë. Vështroi nën gur.

Çfarë të shikonte! Gati sa nuk i ra të fikët. Gjarpëri tërë qejf dhe i krekosur ecte drejt

majës së gurit ku ishte harabeli i vogël. Ai bëri gati helmin te dhëmbi për ta pickuar zogun. Harabeli nuk vonoi, por thirri me zë të fortë: “Ndihmë, ndihmë!”

- Ciu, ciu, ciu, - iu përgjigjën të gëzuar harabelët e tjerë. Ata bashkë me nënën e tyre u gjendën te harabeli sqepverdhë atje te guri. Gjarpëri po afrohej edhe më shumë, gati për ta pickuar. Me ta parë, nëna iu drejtua duke e goditur fort me sqep, gjarpërin në kokë. Ai u kthye sërish nën gur për t'i shpëtuar vdekjes. Por këtë radhë edhe më i dëshpëruar, sepse s'është e lehtë t'i bësh keq tjetrit. Me plagë të shumta i gjakosur në kokë e trup, mes rënkimeve u mblodh si një rreth i ndryshkur hekuri rreth vetes.

Ditët kalonin njëra pas tjetrës e për gjarpërin bëhej më e vështirë. Si e mori pak veten, dhe etja për ujë iu shtua edhe më shumë, mori rrugën drejt burimit që gjendej në fund të pyllit. Kishte kohë pa qënë atje. Ashtu dalëngadalë u gjend te burimi që të shuante etjen që ia kishin shtuar edhe më shumë plagët e marra në trup nga harabelët.



I vinte inat që ja punuan harabelët, por edhe krekosej, po nga inati.

U afrua te burimi. Nxori gjuhën si një thikë me dy presa e filloi të pinte ujë. Ndjente kënaqësi. Kështu po thoshte me vete. Si piu ujë iu kujtua akrepi gjysëm bisht përdredhur. I qe mburrur disa herë atij “Vetëm unë di të helmoj me helmin tim. Sa për të tjerët nuk

pyes fare” - i pat thënë akrepi, por edhe helmuesëve të tjerë. Akrepi e pat dëgjuar me vëmendje por s’ua vinte shumë veshin mburrjeve të gjarpërit. Ai shikonte punën e vet. Helmin e kishte të fortë por kurrë s’kishte helmuar apo t’u mburrej të tjerëve. Fjalë mburrëse kishte dëgjuar vetëm nga zvarraniku gjarpër që kur fliste zgurdullonte sytë si i një marrë mendësh.

Kishte të drejtë akrepi, sepse mburravecëve të kësaj bote i duhej hapur rrugë. Por ama, kur e kërkonte puna edhe i duhej dhënë përgjigje. Nuk thonë kot “i duruari, i fituari!”. Kështu veproji edhe trupvogli harabel por edhe akrepi i vogël që i mburrej ai gjarpër pikalosh.

Si piu ujë gjarpëri mori forcë dhe u krekos përsëri duke thënë: “Kush më del para mua do ta helmoj!” Inati s’i kishte ikur akoma ndaj harabelëve. “Do t’ju shqyej o harabela....!” Fjalët që thoshte, i dëgjoi akrepi që ishte aty te ajo shkurre. Nuk i pëlqyen fjalët e gjarpërit dhe doli nga foleja. Në këtë kohë gjarpëri po ecte rrugës për te guri ku kishte folenë. Akrepi i preu rrugën gjarpërit. Pastaj i tha:

- Pa shiko kush qënka! I madhi gjarpër!?”.

- Hap rrugën se do të helmoj ty me këtë inat që kam, o i vogli akrep!

- Pse çfarë të ka ndodhur? -pyeti akrepi.

- Largohu të thashë! Se të gëlltita si vezë zogu, o i vogëli akrep!

Akrepi qeshi me qësëndi. Pastaj i tha:

- A e provojmë o i madhi gjarpër se kush e ka helmin më të fortë! Ti apo unë?!

- Mirë. - i tha gjarpëri pa e zgjatur. - Po deshe pickomë ti i pari mua!

Akrepi nuk vonoi dhe u afrua te gjarpëri.

## **Akrepi**

Si nxori thumbin shpues e nguli mbi trupin e gjarpërit mburravec dhe derdhi helmin. Pas pak sekondash gjarpëri po dridhej e përdridhej rreth vetes. Helmi që shumë i fortë. Sytë po i dilnin si ato vezët e zogjëve që kishte ngrënë nëpër foletë e shpendëve aty në atë pyll, por edhe te ajo pemë ku ishin

zogjtë sqepverdhë afër folesë së tij. Mbas disa minutash gjarpëri dha shpirt. Para se të mbyllte sytë pa akrepin e vogël me inat, por më kot. Ai dha shpirt me plagë e helmin e akrepit bisht përdredhur në formën e harkut, sepse kishte bërë shumë zullume. - Epo vjen një ditë e paguan të këqiat që u ke bërë të tjerëve në këtë botë, - thoshte me vete gjarpëri që humbi të gjitha shpresat për t'u hakmarrë ndaj të tjerëve e sidomos akrepit që e kishte përbuzur sa e sa herë ngaqë ishte i vogël.





Edhe zogjtë sqepverdhë u gëzuan nga ky lajm që morën.

Epo nuk thonë kot: “Kush bën keq, keq do e pësojë në këtë botë!”.

Akrepi u kthye i qetë te foleja që ishte buzë rruge te ajo shkurre.

## **Livadhi në mal**

### ***PJESA E I<sup>rë</sup>***

Kali dhe Lepuri ishin dy shokë të pandarë. Kudo që shkonin i bënë shoqëri njëri- tjetrit. Ata ishin qejf paprishur. Kur i shikonin kafshët e tjera për shoqërinë e tyre bëheshin shumë ziliqarë.

- More, – thoshin me vete, - si s'u ndanë njëherë këta? Në punë bashkë, në rrugë po ashtu. Edhe në kullotë po sëbashku.”

- E po mirë bëjnë. - thoshin ata që iu donin të mirën. - Se i thonë një fjale: kush ndahet nga shokët e ha ujku. Po, po, ashtu është.

Këtë e dinin dhe dy shokët.

Kudo do t'i gjeje bashkë. Ata ishin një trup i vetëm. Bisht s'i bënë punës. Punonin

shumë, të zotin e shtëpisë nuk e bezdisnin asnjëherë. Bënin punë nga me të ndryshmet. Jo vetëm kaq.

Të zotit të shtëpisë nuk i qenë ankuar asnjëherë për punët e shumta që bënin.

Por edhe ai i trajtonte mirë të dy kafshët punëtore.



## ***PJESA E II<sup>të</sup>***

Një ditë i zoti i shtëpisë, Kalit dhe Lepurit i dha një punë të veshtirë. Ishte kohë vjeshte dhe çdo ditë shirat shtoheshin e bëheshin më të dendura.

- Dëgjoni – u tha i zoti i shtëpisë! - Unë do të shkoj me bagëti në pyll. Ato pak zaire që kemi, duhet t'i kursejmë. Dimri është i gjatë. Ai ende nuk ka filluar.

Të dy shokët e dëgjonin me vëmendje të zotin e shtëpisë. Ishin të lodhur nga punët e ditës. Prisnin se ç'punë i priste të nesërmen. I zoti vazhdoi bisedën:

- Ju do të shkoni për të bluar në mulli. Vetëm pak miell kemi në shtëpi. Sa për dy ditë bukë. E di që rruga është e gjatë. Si mendoni: A mund ta lëmë shtëpinë pa bukë...!?

- Kurrë s' ka për t'u ndodhur kjo poteri...! Ne jemi të gatshëm të bëjmë çdo punë. Do të ishte turp sikur miku të trokasë në derë e të mos i japësh bukë.... ?!

### *PJESA E III<sup>të</sup>*

Tek-tuk kishte ndonjë re që sillej rrotull në qiell. Këndezi e kishte lënë këngën e mëngjesit që po afronte.

Kalit i kishte dalë gjumi më herët se ditët e tjera. Merakun e kishte se si do ta kalonin lumin për në mulli. Por gjumin ia prishi kënga e këndezit sqepverdhë. Nga shiu, qe bërë rrjepacuk, ngaqë kishte bredhur gjithë ditën.

Kjo e kishte hutuar më shumë saqë harroi edhe qymezin. Ndaj atë natë gjumin e bëri në traun e haurit së bashku me kalin dhe lepurin. Kali rrotulloi sytë dhe pa në haur lepurin që ishte shtrirë sa gjërë e gjatë. Edhe ai ishte zgjuar.

Nuk fliste sepse kujtoi se kali ishte në gjumë.

-Ki –ki-ki- kiiiiii ....., - u degjua përsëri kënga e këndezit.

Yjet po rralloheshin.

## *PJESA E IV<sup>t</sup>*

Kur ra dita morën thasët me grurë e u nisën për në muli. Kaluan bregun e u varën poshtë rrugës që të çonte drejt luginës. Para kali, lepurit e ndiqte nga pas. Rruga ishte me baltë. Shiu kishte rënë pa pushim një javë.

Ishin të papërtuar në punë. Kjo i bënte të mos e ndjenin lodhjen gjatë rrugës. Mbas një ore arritën tek lumi. Dy brigjet e lumit i lidhte një urë. Mbi kavot ishin vendosur dërrasa lisi. Por vërshimi i lumit me dallgë shumë e kishte bërë punën e vet. Disa nga dërrasat nga ku mund të kaloje, nuk dihet se çfarë drejtimi kishin marrë.

- Po tani si t'ja bëjmë – thanë me një gojë kali e lepurit.

Qëndruan një copëherë. Rruga i lodhi. Ashtu të ulur vështronin lumin. Morën frymë thellë. Vështruan njëri-tjetrit në sy. Lepuri kishte merak më shumë. Ngaqë kishte trup të

**vogël, uji mund ta merrte lehtë. Ai rrezikonte jetën. Prandaj ra në mendime.**



**Për disa çaste harroi se me kë ishte pranë. Në këtë kohë ndërhyri Kali. Duke folur, prishi qetësinë:**

**-Mos u mërzit o vëllaçko. Do e kalojmë lumin bashkë! Le të bien edhe pak dallgët. Pastaj...**

**- Po si ta kalojmë që të dy ? - pyeti i habitur lepur i. - Në sy pa të çelte gëzimi. Vështronte**

Kalin që nga shëndeti i ndriste qimja sikur të ishte qershor.

Oshëtima e lumit dëgjohej deri lart në fshat. Dielli vjeshtak mezi ngrohte. Frynte një erë e lehtë veriu. Kjo e bënte kohën edhe më të ftohtë. Ishte fund tetori. Fillimet e ditëve të muajit pasardhës do të sillnin dëborë.

Aty afër, ku ishin ulur Kali e Lepuri, në ferrë, me gjysëm zëri këndonte një trumcak gushëverdhë.

- Eja tani e hip në vithet e mija. - i tha kali lepurit veshëgjatë. Në gjoks, pulla e bardhë i ishte bërë gjithë baltë. Lepuri kërcëu dhe u gjend i ulur mbi kalë. Por sytë nuk i hiqte së shikuari vaun e lumit.

- Hë, si të duket vetja tani... ?! Do ja dalim mbanë edhe këtë radhë. Mos u frikëso!

Mbas disa minutash dolën në bregun tjetër të lumit. Lepuri u gëzua shumë. Gati sa nuk fluturonte. Aty afër ishte mulliri. Pasi bluan bereqetin falënderuan mullixhiun e u nisën për rrugë.



Kur aritën në shtëpi ende dielli s'kishte perënduar.

Ai dimër kaloi me shira e dëborë saqë s'mabahej mend ndonjë herë. Pranvera erdhi më shpejt nga sa pritej.

Lajmëtarja e parë, manushaqja çeli më herët se vitet e tjera. Pas saj, luleverdha, e kështu me rradhë të gjitha lulet.

- Do të jetë një vit i mbarë e me bereqet, - u tha i zoti i shtëpisë kafshëve punëtore. - Na presin punë të mëdha në ditët që do të vinë.

Tek fliste këto fjalë, mendimi e kishte pushtuar gjithë qënien e tij.

- Të lumtë goja o i zoti shtëpisë, - iu përgjigjën si në kor kali dhe lepur i gushëbardhë.

## ***PJESA E V<sup>të</sup>***

**Ishte ditë e bukur pranverore. Rrezet e diellit ishin të arta. Natyra kishte marrë pamjen e një qilimi të blertë dhe bashkë me lulet ngjyra-ngjyra dukej si një ylber i vërtetë.**

**Kali dhe lepuri u gëzuan shumë për këtë pranverë të mbarë. Edhe kafshët e tjera i gëzoheshin natyrës së bukur.**



Një ditë kali dhe lepuri biseduan se ku do të kalonin disa ditë pushim. U menduan gjatë. Vendosën të shkonin në mal. Atje na ishte një livadh me bar e lule të bukura.

Ngjyrat e luleve, bari i gjelbër, gjithçka që gjendej në livadh, të jepnin kënaqësi të veçantë. Flladi i bredhave të mbushte gjoksin me ajër të pastër.

I morën lejë të zotit të shtëpisë dhe u nisën për rrugë. Në mal arritën pas disa orësh.

- Ja livadhi - foli i pari lepuri, që kishte dalë në këtë çast para kalit. - Oh sa bukur... ?! Do të kënaqemi sot...! - dhe filloi të ledhatonte me këmbë gjoksin.

Afër livadhit gurgullonte ujë. Ishte çezma me ujë, brisk të ftohtë. Bilbilat këndonin. Kjo ua shtoi më shumë gëzimin.

- Aty qëndro, të freskohemi, o lepurush. - foli Kali.

- Po, po - ia kthehu Lepurushi. Të dy u ulën pranë burimit.

**E ç'mrekulli .... !? Morën frymë thellë. U freskuan. Aty në atë livadh dukej sikur ishin të gjithë të mirat e botës.**



## ***PJESA E VI- të***

Kali po kulloste në livadh. Lepurushi i vogël u afrua pranë një ferre.

Brenda ferrës pa një lule. Ishte ngjyrë lejla. U habit. S'kishte parë lule të tillë ndonjëherë. U afrua me shumë drejt ferrës. I donte shumë lulet. Donte që t'ia çonte dhuratë të zotit të shtëpisë.

– O oooo sa bukur! – tha Lepurushi. Kali vazhdonte i qetë kullotën. Tundëte kokën për të trembur bletët që rrinin mbi lule.

- Kujdes mos u largo shumë. - këshilloi Lepurin, Kali.

- Jo, jo, - iu përgjigj Lepuri, - tek kjo ferrë e vogël jam.

Qe afruar shumë pranë ferrës. E ç'të shikonte! Shtangu në vend. Gati sa nuk i pushoi zemra nga frika. Brenda në ferrë qe strukur Ujku. Sytë i nxirnin xixa. Dhëmbët e mëdhenj i kërciste sikur të bluante urof. Nga goja i dilte shkumë e bardhë. Ai vetëm

shikonte. Priste nga çasti në çast t'i coptonte Kalin dhe Lepurin.

“Heeeee ç’do kënaqem” thoshte me vete Ujku. “Mish kali...! Nuk i thonë shaka. Pa lëre, lëre Lepurushin e vogël! Të gjorët.” - filloi të tallej ujku.

Lepuri e mblodhi veten. U kthye me vrap tek Kali, mori frymë pastaj i tha në vesh.

- O Kalë, o Kalë .....! Në ferrë është Ujku. E dëgjova që thoshte: do ti coptoj.....!

- Si.....! Mos u tremb. Do t’ia punojmë Ujkut! Unë di një lojë. Edhe ujku do ta besojë; - i tha Kali.

Lepuri u gëzua shumë nga fjalët e Kalit.

- Dil nga ferra dhe eja këtu në livadh; - i bërtiti Kali Ujkut. - Ne mezi po prisnim një “shok” si ti. Tek ai shkëmbi në mes të livadhit do të luajmë së bashku.

Ujkut iu bë qejfi kur dëgjoi këto fjalë. U ngrit rëndë-rëndë e tha:

- Pa më tregoni lojën o “vëllezër”. Edhe unë të tillë shokë dua.

Dëgjuan njëri - tjetrin dhe ujkut i pëlqeu shumë loja që i tregoi Kali.

- E ç'presim – u dëgjuan përsëri fjalët e ujkut.  
– Të fillojmë nga loja.

Pranë gurit të madh u afrua Kali. Ndërsa Lepuri, i cili mbante një dru, qëndronte fshehurazi mbrapa shkëmbit.

Ujku qëndroi disa metra larg. Që andej do kërcente mbi Kalin e do të dilte në anën tjetër të shkëmbit. Kali kthehu shpinën nga Ujku. Radhën e parë të kërcimit do ta bënte Ujku.

- Tani jemi gati të fillojmë lojën - tha Kali. Ujku mori vrull, Kali lëvizi në anën tjetër të shkëmbit dhe Ujku u përplas në gurin e madh.

- O bo bo ç'më gjeti, - bërtiti fort Ujku. Oshëtiu mali. Në këtë çast e gjuajti me shkelma Kali. Edhe Lepuri qëlloi me shkop mbi Ujkun. Ujku kërciste dhëmbët nga inati. Por më kot.

- Na edhe një goditje tjetër - i tha Kali. Lepuri nuk pushonte së godituri me shkopin prej

thane. Vendi u skuq nga gjaku i ujkut. Rënkimet shtoheshin. Minutat kalonin, ujku ngordhi. Të këqijat e bishës s'kishin të numëruar. Të zotit të shtëpisë i kishte dëmtuar tufën e bagëtive.

Në mbrëmje u kthyen të gëzuar në shtëpi. Lëkurën e ujkut e mbushën me bar. U habit i zoti i shtëpisë kur i pa me lëkurën e Ujkut në shpinë.

-Ju lumtë! Ju jeni kafshë të mrekullueshme.

Së bashku me të zotin e shtëpisë hynë në shtëpi të gëzuar.



## **Plaku dhe çakenjtë**

Ishte ditë pranvere, atëherë kur plaku me qeleshe të bardhë që e mbante vazhdimisht mbi kokë; po ecte duke peshuar mbi bastunin e tij që nuk e ndante nga dora. Atë ditë shkoi në pyllin që ishte aty afër fshatit.

Kënga e zogjve oshëtinte dhe bashkohej me flladin e erës pranverore. Ngado poleni i luleve shkundej nga fladi i erës së lehtë e përkëdhelëse dhe aroma e tij mbushte mushkëritë e gjallesave. Atje në atë pyll të çuditshëm na ishte edhe një burim. Pranë burimit shkonin e pinin ujë jo vetëm gjallesat e atij pylli por edhe njerëzit që udhëtonin andej; sepse aty na ishte edhe rruga lidhëse me fshatin tjetër, përtej bregut të lumit. Që të shkoje deri aty, duhej patjetër një pushim tek

ai rrap i moçëm, pranë rrënjëve plot me zgarva të së cilit buronte uji i atij burimi.

Beg Bushi pas një ore mbërriti tek burimi i pyllit. Rruga ishte plot kthesa e përmes pyllit gjarpëronte edhe një lumë. Nga thellësia e pyllit dëgjohej deri aty te burimi edhe kënga e gjinkallave. Beg Bushi u afrua pranë burimit. Piu ujë. Freskoi fytyrën. Me duart e lagura u ra flokëve që i kishin rënë mbi ballë dhe i hodhi sipër kokës. Aty afër na ishte edhe një gur i madh me forma të çuditshme. Ai kishte disa shkallë në forma gjysëm rrethi ku mund të uleshe pa vështirësi.

U afrua tek ai gur dhe u ul në një të shkallë.

-Kështu po! -tha Beg Bushi më së fundi dhe tundi kokën. Qeleshja e bardhë i jepte edhe më shumë fisnikërinë e një burri të fortë, si shkëmbi ku ishte ulur. Në krahun e djathtë sipër asaj shkalle në formën e një pirgu dukej qartë një e çarë. Aty vendosi

bastunin. Me duart e ashpra plaku Beg Bushi përkëdheli shkëmbin.

–Eh! -psherëtiu ai. Nga xhepi nxori kutinë e duhanit dhe mbushi çibukun. Njërën dorë e futi në xhepin tjetër, nga ku nxori eshkën dhe masatin. Bëri disa goditje, çuk-çuk mbi gurin e zjarrtë ku qe vendosur eshka. Tymi i eshkës u bashkua në atë çast me erën e luleve të pyllit. Beg Bushi e thithi disa herë çibukun dhe tymi dilte nga goja si shtëllungë reje qiellore.

-Kështu po! -thoshte me vete Beg Bushi. Era e mirë e eshkës ndoshta kërkonte nëpër drurët e pyllit foletë e shoqeve të saj. E pse jo!? Nga drurët ishte marrë e tani ajo digjej për të ndezur çibukun me duhan të Beg Bushit. Edhe bastuni që mbante me vete ai plak nga druri i bushit të atij pylli ishte gëdhendur.

Hodhi sytë edhe një herë rreth e rrotull në atë vend aq të çuditshëm. Pastaj shikimin e nguli mbi atë shkëmb. Mbi atë gur të madh lexoi një mbishkrim ku thuhej: “Kujdes nga çakenjtë!” Kjo e habiti plakun Beg. U nis për

**rrugë drejt urës që të çonte në fshatin përtej  
bregut të lumit.**



**Sapo kishte rënë muzgu i mbrëmjes. Dhe me  
të vërtetë atje në një rrëzë anë të cepit të urës  
pa dy çakenj pylli. Me të parë Beg Bushin  
filluan të ulërinin e kërcisnin dhëmbët.**

**-Po tani! -tha me vete plaku Beg, - dhe  
mendja i shkoi tek mbishkrimi që lexoi në**

shkëmb. Me të shpejtë ndezi eshkën. Nga të çukiturat mbi gurin e zjarrtë me masat dilnin xixëllonja që ndriçonin deri atje ku ishin çakenjtë. Kështu nga frika e xixëllonjave të zjarra ata u larguan me të shpejtë drejt pyllit. Deri tek shtëpia e mikut, atje në breg të lumit Beg Bushin e shoqëroi shkopi prej dru bushi.

- Vetëm ke ardhur? - e pyeti mysafirin i zoti i shtëpisë.

- Po! - iu përgjegj ai.

- S'pate frikë nga çakenjtë! Të dolën te ura?

- Më dolën si nuk më dolën!

I zoti i shtëpisë shtangu nga kjo përgjigje. Pastaj tha:

- Nuk pate frikë nga egërsirat?!

- Të them të drejtën nuk i besova mbishkrimit që ishte në shkëmb. Por kur dolën me të vërtetë në cep të urës, atëherë fillova t'i besoja mbishkrimit. Për mua ishte hera e parë që bëja këtë rrugë, këtej në këto anë, - tha plaku Beg.

- Si i largove egërsirat? - tha i zoti i shtëpisë.

- Po...ja! Pylli ka shumë të mira, por na paska edhe të këqija, si ata çakenjtë...! - Beg Bushi shtoi edhe këto fjalë: - Gurin e zjarrtë, eshkën, shkopin e drunjtë, masatin e hekurt të gjitha pjesë të natyrës e të pyllit. Kur unë u tregova çakenjëve këta elementë, ata u larguan nga frika.

- O zot! Na largo çakenjtë e shoqërisë njerëzore se çakenjtë e pyllit e paskan ilaçin, - tha i zoti i shtëpisë dhe tundi kokën.

- Edhe ata të shoqërisë njerëzore këtë ilaç duan, - tha më së fundi Beg Bushi. Me gotën e rakisë në dorë uroi për mikpritjen të zotin e shtëpisë.

Ndërsa jashtë po binte agu i ditës së re.

## **Nepërka dhe Kaprolli**

Atje në majë të asaj kodre, të veshur me shkurre të shumëllojshme, në skajin fundor qielli dukej sikur puthej me disa shkëmbinj.

Kur shikimin e tretje për aty, që nga livadhi, i cili ishte nën këmbët e kodrës; shkëmbinjtë të silleshin para syve sikur ata do të fluturonin për tek burimi në shtegun e krahut jugperndimor të pyllit. Në atë mjedis plot gjelbërim, në pyllin me shkurre, lule e pemë, ta kishte ënda të shkoje e të pushoje.

Ngado mbretëronte qetësia. Jo më kot, kafshët e pyllit kishin bërë atë zgjidhje për të jetuar në atë oaz të vërtetë. Kënga e zogjëve aty, oshëtinte çdo ditë. Cicërimat e tyre nëpër atë pyll. formonin vërtetë orkestrën më të bukur.

-Sa e magjishme ishte orkestra e kënga e zogjëve!?. . . .

Në atë pyll aq të mahnitshëm kalonte edhe një rrugë këmbësore që lidhte anën tjetër të kodrës përtej atij pylli. Si në pranverë, ashtu dhe në dimër, aty kishte gjallëri. Të gjithë gjallesat jetonin në harmoni me njëra-tjetrën: nga zogjtë, pëllumbat, fluturat, mizat, kafshët e zvarranikët. Nuk mungonte edhe kuvendimi i këngës së gjinkallave nëpër drurët e shkurret e pyllit. Në degët e pemëve zogjtë kishin ndërtuar foletë me fije bari e baltë të marrë te burimi i pyllit. Ndërsa atje në majë të kodrës shkëmbinjtë kryeneçë mbanin mbi supet e tyre foletë e pëllumbave.

Kështu, shkëmbinjtë me të çara aty-këtu, formonin shumë strehëza si kapele në trupin e tyre. Për pëllumbat ato ishin bërë shtëpia ku kalonin gjumin e natës. Gu, gu, gu.... me zhurmën e tyre karakteristike që lëshonin gjatë natës, thyenin qetësinë e muzgjeve të mbrëmjeve. Kjo gu-gu e zërit kumbues të pëllumbave përgjatë natës, ishte ninulla e këngës së gjumit për gjallesat në atë pyll.





**-Sa mirë ishte që nga ata shkëmbinj të shkoje  
e të vështroje peizazhin e pyllit ku të  
përkëdhelte fladi i erës së bashku me  
aromën e luleve!**

**Po këtë fat e kishin zgjedhur vetëm  
pëllumbat. Kjo për ta ishte dhuratë nga zoti!**

- Sa e mrekullueshme është jeta këtu në mes të pyllit gjelbëror, ku kënga e bilbilave, gurgullima e ujrave që rrjedhin nga burimet, fëshfërimat e gjetheve, e çdo gjë në lëvizje në këtë mjedis natyror, të bën me krahë, si të pëllumbave që lodrojnë në qiell për të kapur retë e bardha fluturuese, -thoshte me vete rojtari i pyllit sa herë që kalonte andej.

Por në guvat e atyre shkëmbinjëve, në një zgavër të fshehtë poshtë shkëmbit na ishte edhe një nepërkë me ngjyrë të verdhë. Ajo kishte vite që banonte aty. Kur u nda nga jeta kolektive që bënte në pyll, ishte e vogël, por si tinzare që qe, një ditë ashtu pa e vënë re edhe vetë u gjend te shkëmbinjtë.

-Kështu po, -tha me vete pasi mori frymë thellë. Në zgavrën e shkëmbit zuri vend e filloi të bëjë një jetë të vetmuar. Ditën shullehej sipër shkëmbit, ndërsa natën futej midis zgavrës, poshtë gurit. Kalonin ditë e netë e për Nepërkën verdhushe vështirësitë shtoheshin edhe më shumë. Ishte e ngopur kur erdhi nga pylli, por tani kishte shumë uri.

-Po tani, -mendoj ajo, - ku do gjej ushqim?

Sa për ujë, kishte shfrytëzuar atë pak lagështi që rezervonte strofka e zgavrës së folesë. Një natë nga urija që kishte, s'po e zinte gjumi. Dëgjoi disa tinguj, gu, gu, gu...!

-Ç'të jenë këta tinguj?! S'i kam dëgjuar ndonjëherë atje kur isha me shoqet në pyll!

Edhe këtu ditë më parë s'u kishte vënë shumë rëndësi atyre gugatjeve. Doli jashtë zgavrës. Mbështeti trupin mbi shkëmb, dhe me kokën lart përgjoi nga vinin tingujt e asaj nate. Tingujt vinin nga shpella shkëmbore atje mbi follenë e saj. Me sytë e vegjël, por me rreze drite shikimi që çante errësirën, pa se aty jetonin pëllumba. Nga ky çast, Nepërka verdhushe u gëzua pamasë.

-Edhe çështjen e ushqimit e zgjidha, -tha me vete përsëri ajo, dhe me gjuhën e hollë lëpiu buzët e plasaritura nga etja për ujë.

Kur pëllumbat largoheshin ditën nga foletë e tyre, për ushqim për vete dhe të vegjël, Nepërka verdhushe shkonte dhe u hante ushqimin. Ajo kishte arritur deri aty sa që pëllumbave u hante edhe vezët dhe të vegjël, e sapo lindur.



**-Oh, sa mirë qënka jeta e shullërit në vetmi këtu tek shkëmbi i pëllumbave, -tha më së fundi Nepërka verdhushe.**

**..... Pëllumbat u shqetësuan për këtë fatkeqësi që u ndodhte herë pas here e s'po gjenin dot shkaktarin e vërtetë. Kështu në**

kolektiv vendosën që të largoheshin tek shkëmbinjtë në kodrën aty përballë.

Pas disa ditësh, meqë kishte uri, Nepërka u nis për te foletë e pëllumbave. Gjithë serbes e kënaqësi u gjend në shpellë. Çfarë të shikonte aty!? Foletë në shpellën e pëllumbave qenë boshatisur tërësisht. Vështroi gjithandej, por më kot. Pëllumbat ishin larguar përfundimisht për të mos u kthyer më kurrë në atë vend kobëzi.

Nepërka verdhushë e dëshpëruar u kthye në strofkën e saj. Vapa përvëluese dhe uri ja i vështirësuan jetën. Në strofkë s'kishte më lagështi. Kjo i shtonte më shumë etjen për ujë.

Kaprolli qimebutë me ngjyrë të kaftë, doli nga pylli e shkoi tek burimi që ishte pranë shtegut të livadhit. Zgjati kokën drejt pellgut me ujë. Pasi piu ujë, vështroi drejt shkëmbinjëve atje lart në kodër.

- Pse mos të shkoj deri atje? -tha me vete Kaprolli. - Më ka marrë malli të vështroj pyllin që andej nga shkëmbinjtë! Si u mendua edhe një herë, më së fundi vendosi të ngjitej deri

atje. Pas disa minutash u gjend sipër shkëmbit.

-Sa i bukur është pylli ynë, -foli me vete Kaprolli.

Kur po zbriste nga shkëmbi, në fund të tij pa Nepërkën verdhushe.

-Po ti ç'bën këtu? - i tha Kaprolli Nepërkës. S'të kam parë me shoqet atje në pyll!

-Mos u çudit! Unë jam Nepërka verdhushe e sullërit. S'kam shoqe apo shokë si po më thua ti! Jetoj e vetme këtu tek shkëmbinjtë.... Dua një nder nga ty.

-Për çfarë e ke fjalën moj Nepërkë?

Po.... ja, unë kam etje e s'di ku ka ndonjë burim këtu afër! Ma mori frymën kjo e shkretë vapë e korrikut. Nuk e shikon si jam bërë, sa edhe buzët më janë plasaritur.....

- Mirë, - i tha Kaprolli. - di një burim që është këtu afër. - Pastaj shtoi: - Eja pas meje që të zbresim tek livadhi, se aty gjendet burimi.

Kështu, Kaprolli para e Nepërka pas, arritën më në fund pranë burimit. Gjatë rrugës, ajo

mezi zvarritej dhe për këtë Kaprollit i vinte keq.

- Hë moj zonja Nepërkë, tashti shuaje etjen e trupit me ujë të ftohtë nga pellgu ynë!

Nga kjo fjalë Nepërka mbeti e çuditur duke thënë me vete: “Pse pellgu i këtyre qënka ky!? Pse të mos jetë i Nepërkës verdhushe që shullëhet në shkëmbinj?”

Pastaj si me dashamirësi i tha Kaprollit:

-Nuk mund të pi ujë para teje!

-Kemi respekt për miqtë e rinj ne të pyllit, - shtoi Kaprolli.

Më në fund Nepërka iu bind atij dhe piu ujë në pellgun e burimit. -Kështu po, - dhe e kënaqur doli në anën tjetër të pellgut sipër një guri duke u krekosur. Herë pas here nxirrte gjuhën jashtë dhe vështrome drejt Kaprollit. Në këtë moment, diçka po mendonte për keq ndaj mikut që i shpëtoi jetën nga etja.

“Do ta pickoj në kokë e t’i derdh helmin aty. Kështu pellgu e burimi do mbetet i imi” tha me vete Nepërka.

**-U kënaqe moj zonja Nepërkë! - foli Kaprolli.**

**-Si jo “i dashur” Kaproll! Edhe ai u afrua pranë pellgut e zgjati kokën për të pirë ujë. Në pellg u shfaqën dy Kaprollë. Njëra ishte shëmbëlltyra e tij.**

**“Tashti është momenti”, -tha Nepërka. “Ta sulmoj në kokë!” Si mori shenjë u hodh drejt e në pellgun me ujë. Sulmi që i gabuar: në fakt kishte derdhur helmin në kokën e shëmbëlltyrës së “mikut” të pyllit. U zhyt e gjitha në pellgun me ujë dhe humbi brenda tij.**

**Në këtë kohë Kaprolli u tremb dhe ngriti kokën lart. Vështroi sa andej e sa këtej, por edhe Nepërkën s’e pa atë çast tek guri.**

**-Po kjo ç’u bë?! - Në pellgun me ujë pa ngjyrë të verdhë që kishte mbuluar gjithë sipërfaqen. Dhe pak më tutje pa Nepërkën, por jo pranë gurit si më parë. Kaprolli e kuptoj skenën e “zonjës” por nuk bëri zë.**

**-Të falnderoj, i tha më së fundi Nepërka, por me gjysëm zëri.**

**-Eja në pyll me ne - i tha Kaprolli.**



**-Jo, do shkoj në shtëpinë time. A më përcjell deri atje!**

**-Pse jo, - i tha ai. E çoi deri te shpella e pëllumbave dhe u kthye përsëri tek shokët në pyll.**

**.... Pas një kohe të gjatë, Kaprolli shkoi përsëri te shpella e pëllumbave, sepse Nepërkën s'e kishte parë më që nga ajo ditë tek pellgu me ujë. Para se të hipte mbi shkëmb, dëgjoi një rënkim që thoshte "Ndihmë, ndihmë". Ajo ishte Nepërka verdhushe. Shkëmbi ishte çarë e poshtë tij kishte zënë gjysmën e trupit të Nepërkës.**

**Ajo po jepte shpirt. Të bërtiturat për ndihmë i kishin dëgjuar edhe pëllumbat. Kur panë Kaprollin te shkëmbi, edhe pëllumbat u kthyen aty. Nga ky çast mësuan se ishte Nepërka ajo që u kishte sjellë fatkeqësi atyre.**

**-Na kërkoke edhe ndihmë, pale, pale, -thanë në kor pëllumbat duke shprehur mllëfin e tyre.**

**-Edhe mua desh më helmoi, - foli më së fundi Kaprolli.**

**Pastaj thanë:**

**- Kush do t'i bëjë gropën tjetrit ka bërë më parë të vetin.**

**- Eja të shkojmë, - u dëgjua e folura e ëmbël e Kaprollit.**

**..... Dhe u nisën drejt foleve ku i prisnin shokët e tjerë atje në pyll.**

**Durrës, qershor 2016**

## **Përmbajtja**

Mbreti dhe molla e kuqe.....	7
Gjarpëri pikalosh, akrepi gjysëm bisht përdredhur dhe harabeli sqepverdhë.....	16
Livadhi në mal.....	26
Plaku dhe çakenjtë.....	41
Nepërka dhe kaprolli.....	47

## *Biografi*

Ka lindur në fshatin Leskovë Tomorricë-Skrapar në vitin 1959. Arsimin fillor e të mesëm e kryen në vendlindje viti 1981. Vazhdoi për Kulturën Masive (Degën e Librit) në Korçë e kryen atë shkëlqyeshëm në vitin 1990. Pranë gazetës "Jehona e Skraparit" ka kryer kursin e gazetarisë. Nga viti 1978 deri më 1987 ai ka bashkëpunuar me Kabinetin e Gjuhësisë së rrethit Skrapar (sektorin e leksikologjisë dhe leksikografisë).

Krijimtarinë e ka nisur që herët qysh kur ishte nxënës në bankat e shkollës 8- vjeçare. Fillimisht ka botuar në revistat "Fatosi" e "Pionieri". Më vonë prej vitit 1976 e deri sot shkruan e boton në gjithë medien e shkruar dhe atë elektronike. Në vitin 1984 merr çmim të parë në festivalin kombëtar të këngës për fëmijë që u organizua në qytetin e Shkodrës; me titullin e këngës "Ligjëron nëna për djalin" të kompozuar nga Hajri Xhamëni. Po kështu ka shkruar tekste këngësh folklorike. Kënga me motive të dasmës së krahinës së Skraparit "Moj nuse faqe simite" merr çmimin e dytë në festivalin folklorik të Gjirokastrës.

Është autor i katër këngëve që janë hedhur në disk të kënduara nga këngëtarët popullorë Asllan Ibro e Bajram Haxhillari në vitin 2009 dhe 2013 -ën. Tekstet e këngëve iu kushtohen dëshmorëve të Vlushës (të vrarë në luftën e Dytë Botërore-

1944); si dhe Astrit Sulit - Dëshmor i Kombit i cili dha jetën për çlirimin e Kosovës në vitin 1999.

Në vitin 2009 merr pjesë në konkursin letrar për tregimin më të mirë të organizuar nga shtëpia botuese "Ada" dhe revista "Obelisk" ku tregimi me titull "Hijet e harresës" hyn në antologjinë "Tapeti i tregimit". Me poezinë "Nëna" merr pjesë në antologjinë "Lotët e Virgjër" me autor Agim Mato – Fatmir Terziu botuar nga "APCO" 8 mars 2012 në Londër, ku midis 143 poetëve nga gjithë trojet shqiptare është edhe emri i poetit Xhevahir Cirongu. Ka marrë pjesë me poezitë e tij të botuara në 10 antologjitë me poezi që ka botuar shtëpia botuese "Muzgu" në Tiranë. Po kështu autori Xhevahir Cirongu është edhe redaktor e korrektor i mbi 70 librave.

Poezitë e Xh. Cirongut janë vlerësuar edhe nga kritikë e studiues të ndryshëm. Të tillë janë Faik Xhani – Tiranë e Pjetër Cara – Durrës, i cili vlerëson poezitë te libri me titullin "Bisedë me poezinë" midis autorëve të tjerë edhe krijuesin e trevës së Skraparit poetin nga Leskova e Tomorricës Xhevahir Cirongu. Ka punuar në Kulturë e telekom deri në vitin 1990. Sot shkruan në mediat e shkruara dhe ato elektronike në të gjitha fushat gazetareske e letrare. Deri tani është autor i 10 librave.

Ka në proces botimi edhe 4 të tjerë me tematikë të ndryshme. Deri më sot publicisti, poeti e shkrimtari Xhevahir Cirongu në fushën e gazetarisë ka botuar rreth 3000 mijë artikuj të fushave të ndryshme në publicistikë e letërsi.

Jo vetëm kaq, Xhevahiri është edhe një kritik e vlerësues i mirë letrar. Janë me dhjetra kritika vlerësuese që u ka bërë shumë

autorëve rreth librave të tyre në Shqipëri e Kosovë. Ai di të qëndisë bukur fjalën e shkruar dhe të bëjë vlerësim real që mirëpritet nga lexuesi i mirëfilltë letrar. Ka bashkëpunuar dhe është bashkëpunëtor i shumë gazetave e revistave brenda dhe jashtë vendit. Ka botuar e boton shkrime në revistat: "Fatosi" "Pionieri" "Shqiptarja e re" "Hosteni" "Obelisk" "Dituria" "Metafora" "Vegime letrar" "Pavdekësia" "Krahu i shqiponjës" etj. Por edhe në gazetatat "Jehona e Skraparit", "Luftëtari", "Puna", "Zëri i rinisë", "Bulevard", "E vërteta", "Ndryshe", "Zëri i popullit", "Republika", "Kushtrim brezash", "Telegraf", po edhe te "Drita", "Muzgu", "Dielli i Tomorrit", "Nacional", "Dëshnica", "Golloborda", "Tirana observer", "Fryme e Re" por gjithashtu tek "Lajmi", "Bota sot" në Kosovë etj. *Në vitin 1986 vlerësohet me Medalien "Naim Frashëri". Gjithashtu Xhevahiri merr pjesë në "Ditët Naimiane" që organizohet për çdo vit në Përmet ku përfshihet me një poezi në këtë antologji.*

Korespondent i radios Zëri i Arbërit në Norvegji për emisionin Çamëria. Xhevahiri është bashkëpunor në shumë portale elektronike ku ai shkruan e pasqyron të gjitha gjinitë gazetareske e letrare brenda dhe jashtë vendit.

Është antar i Klubit të Shkrimtarëve e Artistëve - Durrës.

### ***Botime të autorit:***

Kush ia shkeli syrin Ildës, poezi (2005)

Tomorrica zemra jonë (bashkëautor), monografi (2009)

Shpirtit i thërres, poezi (2009)

Mall nga oqeani publicistik, poezi, tregime (2010)

Misteri i një gruaje, tregime (2010)

Bisqet e gjakut, monografi histori (2013)

Kosmogonia e një poeti kosovar (bashkëautor)

Përmbledhje, kritika vlerësuese letrare (2014)

Tomorri qiell perëndie, publicistikë (2015)

Pena e Bedri Tahirit përjetëson lavdinë

tonë kombëtare, histori (Bashkautor) (2015)

Kënga e lotit, poezi (2016)

Livadhi në mal (Përralla për fëmijë) – (2017)

**CIP Katalogimi në botim BK Tiranë**

Cirongu, Xhevahir

Livadhi në mal: përralla për fëmijë / Xhevahir Cirongu;

Ilustrimet: Fatbardha Lile. –

Durrës: Botimet Jozef, 2017

64 f. : me il. ; 14,5 x 21 cm.

ISBN 978-9928-241-12-2

1.Letërsia shqipe 2.Letërsia për fëmijë 3.Përralla

821.18 -93 -34